



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 63 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 6 paragrafi 1 germa c) dhe në zbatim të nenit 11 të Rregullës nr.01/2013, Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** me datë 02.03.2018 merrë këtë:

### **V E N D I M**

#### **Për pezullimin e Partisë Politike – PARTIA E BALLIT –PB**

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës që të pezullohet Partia Politike “Partia e Ballit -PB”, për mosdorëzimin e të dhënave të ndryshuara vjetore.
- II. Partia Politike, “Partia e Ballit -PB”, pas marrjes së vendimit ka afat të shtuar prej njëzet (20) ditësh për të dorëzuar të dhënat e ndryshuara vjetore.
- III. Obligohet Zyra që ta njoftoj përfaqësuesin e Partisë Politike “Partia e Ballit -PB”, për marrjen e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

### **Arsyetim**

*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve muar vendim që të pezulloj nga regjistri i partive Partisë politike, “Partia e Ballit -PB” sipas nenit 6 paragrafi 1 germa c) të Rregullës nr. 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike. Partia politike nuk ka përmbushur obligimet që dalin nga neni 11 të Rregullës 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, respektivisht nuk i ka dorëzuar përditësimet (azhurnimet vjetore) deri më 31 janar 2018.*

**Këshillë juridike:** Përfaqësuesi i Partisë Politike, “Partia e Ballit -PB”, nga marrja e këtij vendimi, ka të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa – PZAP, brenda 24 orëve .

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

  
Valdete Daka